



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti  
Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor  
Nr : 04-353/01-130112  
Data: 29.10.2024  
P r i z r e n

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

**DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM HAPËSIROR KK – PRIZREN,** me kërkesën e **Salajdin Fanaj B.I.** me banim në **Prizren**, me të cilën ka kërkuar leje për **“gropim për infrastrukture për kyqje në rrjetin e ujësjellësit dhe vendosjen e pusetës “** ne Prizren, në bazë të nenit 3 paragrafi 1 pika 1.1, 1.4, 1.24, si dhe nenit 5, paragrafit 1.1 e lidhur me nenit 15 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit për Ndërtim numër 04/L-110, nenit 3 të Ligjit për Planifikim Hapësinor dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 – Numër 001-011-48192 të datës 31. 03. 2022 si dhe konform nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44, 46, 47, 48 dhe nenit 125 të L.P.P.A numër 05/031 të datës 25. 05. 2016 si dhe neni 142 paragrafi 3 vendimit Komunal për Rregullimin e qytetit dhe të shërbimeve komunale numër 01/011-2 data 18. 11. 2004 merr këtë:

## A K T V E N D I M

**I LEJOHET: Salajdin Fanaj B.I.** me banim në **Prizren**, me të cilën ka kërkuar leje për **“gropim për infrastrukture për kyqje në rrjetin e ujësjellësit dhe vendosjen e pusetës “** ne //” pn.//. e cila do të bëhet në ng.kadast. **P-71813068-05404-7 Zk.Prizren**

- I.** Datën e fillimit të punimeve investitori është i obliguar që të lajmërojë inspektionin komunal në afat prej 8 ditësh.
  - II.** Vendosja e rrjetit të bëhet sipas dokumentacioni teknik.-projektit.
- Investitori është i obliguar që punimet të kryen në bazë të dokumentacioni teknik-projektë e në pajtim me normat ndërtimore dhe rregullave teknike për kësi llojë punime.

Kjo Leje bazohet në shqyrtimin e provave:

- Leje Hyrje nga KEDS NR. 1140 të datës 28.10.2024.
- Sipas pëlqimit të Drejtorisë Shërbimeve Publike Nr. 05-343/01-0141062/24 të datës 28.10.2024. cekjet se si do të zhvillohen punimet-egzekutimi
- Sipas pëlqimit Hidroregjioni Jugor Nr. 4432, të datës 28.10.2024.
- Sipas pëlqimit Telekomit të Kosovës – Departamenti Teknik Nr. 320/2024 të datës 15.10.2024.
- Sipas pëlqimit K.R.U. „Radoniqi – Dukagjini” Sh.A. Nr.746 dt.23.10.2024. me kujdes të veqante gjate punimve dhe të gjitha havarite dhe rreziqet që do të ndodhin pergjegjes eshte vet investitori-egzekutuesit.

**III.** Investitori është i obliguar që punimet rreth infrastruktures teknike të kryen sipas Aktvendimit të dhëna, kurse vend punimi natën të ndriqohet me dritë ashtu që të mundësohet qarkullimi i lirë i automjeteve dhe të këmbësorëve, kurse materialet të tjera duhet të menjanohen nga rruga ku janë kryer punimet.

IV. Ky aktvendim pushon të vlejë në rastë se me punë nuk fillohet mbrenda afatit prej 12(dymbdhjetë) muajsh,duke llogaritur nga dita e marjes së të njëjtës

V. Pas kryerjes së punimeve Investitori është i obliguar që vendin menjëherë të bjerë në gjendje të mëparshme dhe cdo demtim obligimi mbetet investitorrit.

VI. Në qoftëse punimet në infrastrukture nuk mund të kryen në afatin e lejuar, Investitori është i obliguar që të kërkoj nga ky organ leje për vazhdimin e afatit të punimeve.

## A r s y e t i m

Lejohet **Salajdin Fanaj B.I.** me banim në **Prizren**, me të cilën ka kërkuar leje për **“gropim për infrastrukture për kyqje në rrjetin e ujësjellësit dhe vendosjen e pusëtës”** ne rr.//” pn.//. e cila do te behet ne ng.kadast. **P-71813068-05404-7 Zk.Prizren**, Duke shqyrtuar kërkesën e Investitorit si dhe dokumentacionit teknik dhe të shtojcave tjera të prezentuara s’bashku me kërkesë vërtetohet se:

Në proceduren paraprake është kontrolluar dokumentacioni teknik nga ana e bashkëpunorit profesional.

Në kuptim të dispozitave të lartë theksuara është konstatuar se janë plotësuar kushtet për dhënien e lejes për për **“gropim për infrastrukture për kyqje në rrjetin e ujësjellësit dhe vendosjen e pusëtës”** ne Prizren.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e marjes së të njëjtës Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor-Prishtinë.

Ankesa taksohet me 0,50 Euro taksa administrative.



**Bashkëpunëtor profesional:**



---

**Gazmend Berisha, Msc.ndërt.**

**DREJTORI:**



---

**Pranverim Berisha, jur. dip.**